



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12 nëntor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1315_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Shkresën e Ndërmarrjes Publike – Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. të datës 29 tetor 2020.

Pas shqyrtimit të shkresës dhe bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 12 nëntor 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2020/2021, siç janë paraqitur në tabelën 'II.1', që do të zbatohen nga data e nxerrjes së këtij vendimi.

Arsyetim

1. Me datë 29 tetor 2020, Zyra e Rregullatorit për energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a., me anë të secilës ZRRE njohtohet për arsyet që pamundësojnë një aplikim të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale, për shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2020/2021. Arsyet e cekura në shkresë përmbledhen në vijim:
 - Vonesat në realizimin e punëve ndërtimore dhe instaluese të ngrohtores së re dhe njësisë së kogjenerimit me biomasë në vlerë prej rreth 14 milion Euro të financuar nga BE. Ky projekt ka filluar në fund të dhjetorit 2019 (inaugurimi i fillimit të punimeve me 10 dhjetor 2019), ku me planin e implementimit ishte paraparë që punimet të përfundojnë në tetor 2020. Mirëpo për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19 dhe pengesave operative dhe logjistike gjatë kësaj periudhe, janë shkaktuar vonesa disa mujore. Kështu që me planin e azhurnuar të implementimit parashihet që faza testuese e stabilimenteve të prodhimit të energjisë termike të filloj në gjysmën e dytë të dhjetorit 2020, ndërsa testimi i stabilimenteve të kogjenerimit parashihet të filloj në prill 2021.
 - Sa i përket prodhimit të energjisë termike nga kaldajat me mazut në ngrohtoren e vjetër, është theksuar se prodhimi i energjisë termike është i pamundur për shkak të gjendjes teknike të keqe të këtyre stabilimenteve që nuk sigurojnë prodhim të qëndrueshëm të



energjisë termike; po ashtu theksohet se, situata aktuale financiare e NQ Gjakovës pamundëson sigurimin e sasive të mjaftueshme për shkak të çmimit të lartë.

- Bazuar në faktet e paraqitura më lartë lidhur me shtyerjen e afateve të realizimit të projektit të ngrrohtores së re, theksohet se kjo pamundëson një planifikim real dhe të bazuar, i cili është i nevojshëm për një shqyrtim të mirëfilltarifor për sezonin 2020/2021.

2. Bordi i ZRRE-së ka mirëkuptuar faktet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakovës, por megjithatë ka kërkuar të ndërmerret një vlerësim gjithëpërfshirës i ecurisë së zhvillimit të projektit të ngrrohtores së re dhe njësisë së kogjenerimit me biomasë. Në këtë kuptim, përveç informatave nga monitorimet e mëhershme, është organizuar një takim mes ZRRE-së dhe NQ Gjakovës ku janë diskutuar në detaje qështjen e ndërlidhura me realizimin e ndërtimit të ngrrohtores së re dhe pashtu është realizuar vizitë monitoruese ku Bordi i ZRRE-së dhe stafi përkatës janë njohtuar nga afër me ecurinë e punimeve.

Përgjithësisht është vlerësuar se:

- Afatet kohore të parapara në Planin fillestar të implementimit të projektit janë tejkaluar për disa muaj për shkak të pengesave operative dhe logjistike të krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19.
- Me planin e reviduar të implementimit parashihet që faza testuese e stabilimenteve të energjisë termike të fillojë në gjysmën e dytë të dhjetorit, rreth 2 muaj pas fillimit zyrtarë të sezonit të ngrohjes. Në fakt kjo ndikon në shkurtimin e sezonit të ngrohjes dhe periudhës planifikuese dhe paraqet vështirësi sidomos në parashikimin prodhimit dhe furnizimit të konsumatorëve me energji termike dhe kostove përkatëse të ndërlidhura me prodhimin dhe furnizimin; për më tepër kur, për shkak të natyrës tekniko-teknologjike, nuk mund të ketë siguri në kohëzgjatjen dhe rezultatet e fazës testuese.
- Duke ju referuar monitorimit në vend-ngjarje dhe dinamikës së zhvillimit të punimeve ndërtimore dhe instaluese, nuk mund të konfirmohet me saktësi fillimi i fazës testuese siç është paraparë me planin e azhurnuar të implementimit; për më tepër kur disa pozicione ndërtimore (siç janë tubacionet shtesë të rrjetit të energjisë termike dhe linja e kyçjes në rrjetin e energjisë elektrike) janë të kushtëzuara me kushtet atmosferike në sezonin dimëror.

Vlerësimet e lartëpëshkrura për ecurinë e realizimit të projektit të ngrrohtores së re dhe njësisë së kogjenerimit, argumentojnë se aktualisht është shumë e vështirë të bëhet çfarëdo planifikimi (parashikimi) real dhe mjaftueshëm i saktë për të ndërmarrë një shqyrtim të mirëfillt tarifor, që do rezultonte me përcaktim korrekt të të Hyrave të lejuara dhe tarifave të NQ Gjakovës për sezonin 2020/2021.

3. Bordi i ZRRE ka marrë parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakovës, si dhe Vlerësimin e ZRRE-së për gjendjen dhe performacën financiare dhe energjetike të NQ Gjakovës, duke i konsideruar të drejta dhe të argumentuara, dhe rrjedhimisht ka vendosur që tarifën e energjisë termike për sezonin 2020/2021 të mbesin të njëjta si në sezonin e kaluar 2019/2020.
4. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Gjakovës dhe Vlerësimet e ZRRE-së, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakovë sh.a. për sezonin e ngrohjes 2020/2021 është dhënë në tabelën II.1 më poshtë.




Tabela II.1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a. – sezoni 2020/2021

TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2020/2021			
A: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.91	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	58.76	
B: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.09	0.12
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m ² për muaj]	0.88	1.27

- III. NQ Gjakova sh.a. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në tabelën II.1 të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova, për të verifikuar realizimin e të hyrave dhe kostove të realizuara në sezonin 2020/2021.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga NQ Gjakova nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi gjer në shqyrtimin e ardhshëm tarifor; ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d.Kryesues i Bordit


Besim Sejfiqaj, Anëtar


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar



Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së